

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË LIDHEN ME AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT	SPECIAL CHAMBER OF THE SUPREME COURT OF KOSOVO ON PRIVATIZATION AGENCY OF KOSOVO RELATED MATTERS	POSEBNA KOMORA VRHOVNOG SUDA KOSOVA ZA PITANJA KOJA SE ODNOSE NA KOSOVSKU AGENCIJU ZA PRIVATIZACIJU
--	---	--

11 maj 2012

SCC-08-0240

Paditës

J.V.R., XX

Përfaqësuar nga XX, avokat nga XX

Kundër

I paditur

XX, Kombinati bujqësor dhe industrial, XX

Kolegji i specializuar i përbërë nga Alfred Graf von Keyserlingk, Gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Ilmi Bajrami, Gjyqtarë, lëshon këtë

A K T G J Y K I M

- 1. Padia refuzohet si e pabazë.**
- 2. Paditësi detyrohet të paguajë taksë gjyqësore në shumën e 50 eurove.**

Rrethanat procedurale dhe faktike

Më 31 korrik 2008, Paditësi ka ngritur padi në Dhomën e Posaçme me të cilën kërkohet e drejta e pronësisë mbi ngastrat kadastrale 482, 821 dhe 959, në zonën kadastrale Babin Most, e regjistruar në emër të paditësit (Lista poseduese 110), regjistrimi i pronës në emër të tij në kadastrë dhe ri-imbursimi i shpenzimeve procedurale.

Paditësi pretendon se në vitin 1963 babai i tij i ndjerë, V.R., ia kishte dhuruar pronën Komunës së Prishtinës, pa kompensim, por në këmbim të shtesave për fëmijë. Paditësi deklaron se babai i tij nuk i ka marrë asnjëherë shtesat dhe për këtë arsye ai ka kërkuar prishjen e kontratës, e cila nuk ishte e suksesshme. Në vitin 1964 Komuna ia kishte ndarë pronën të Paditurës. Paditësi pohon se kontrata ishte me kusht të marrjes së shtesave dhe për këtë arsye prona duhet t'i kthehet atij si pasardhësi i tij.

Po ashtu, prona nuk është përdorur asnjëherë nga Komuna ose i padituri, por nga paditësi dhe paraardhësi i tij. Paditësi ka deklaruar se ai nuk ka vendim të trashëgimisë, sepse prona është e regjistruar në emër të të paditurit.

Paditësi paraqet: Vendimin e datës 30 shtator 1963, certifikatën e 7 qershorit 1989 se babai i paditësit nuk i ka marrë asnjëherë shtesat e fëmijëve.

Më 15 maj 2009, Trupi Gjykses e ka hedhur poshtë padinë si të papranueshme mbi bazë të asaj se paditësi nuk e kishte dorëzuar vendimin e trashëgimisë.

Më 12 janar 2010, Kolegji i Ankesave e kishte anuluar aktvendimin dhe e kishte kthyer çështjen për rigjykim me arsyetimin se mosparaqitja në gjykatë nga paditësi e dëshmisë së kërkuar nuk do ta bënte padinë të papranueshme.

Më 12 maj 2010 padia i është dërguar AKP-së si administratore e të Paditurit.

Në mbrojtje të padisë së 8 qershorit 2010 i Padituri pohon se padia duhet të refuzohet si e pabazuar. Transferimi i pronësisë që ishte bërë në vitin 1963 ka qenë i vlefshëm me ligjin jugosllav dhe mbetet i vlefshëm sipas ligjit në fuqi tani në Kosovë. I padituri pohon se paditësi nuk e ka paraqitur vendimin e trashëgimisë dhe nuk e njoftuar AKP-në 60 ditë më herët për padinë e tij 60 ditë.

Në seancën dëgjimore të mbajtur më 24 nëntor 2011, paditësi ka deklaruar se padia e tij për kthimin e pronës bazohet gjithashtu në faktin se që nga viti 1963 prona ishte në zotërim nga paditësi dhe babai i tij dhe i padituri nuk e kishte ndërprerë këtë. Paditësi ka deklaruar se arsyeja pse ai nuk ka vendim të trashëgimisë është se ai nuk ka certifikatë pronësie. Paditësi ka deklaruar se në pajtim me Ligjin për Detyrimet ai duhet të ketë të drejtë për kompensim për transferimin e tokës së tij në pronësi shoqërore. I padituri ka deklaruar se prona i është dhënë vullnetarisht komunës, jo NSh-së, prandaj padia kundër NSh-së është e pabazë. I padituri ka deklaruar se nuk ekziston asnjë shënim për shtesat e fëmijëve në kontratë, duke kontestuar se paditësi ka qenë duke e shfrytëzuar tokën.

Në seancën dëgjimore të mbajtur më 19 prill 2012 palët qëndruan pas paraqitjeve dhe kërkesave të tyre të mëhershme. I padituri gjithashtu ka deklaruar se afati i fundit për të kërkuar anulimin e kontratës së donacionit është tre vjet nga përmbyllja e saj në vitin 1963 dhe i është referuar jurisprudencës së gjykatave në Kosovë dhe Ligjit për Detyrimet të vitit 1978.

Arsyetimi ligjor

1. Padia është e pabazë.

a:

Kjo tashmë rezulton nga fakti se paditësi nuk e ka dëshmuar faktin e kontestuar se ai është trashëgimtari, dhe i vetmi trashëgimtar i babait të tij, të ndjerit V.R. Gjykata nuk mundet thjesht të supozojë se kështu është gjendja dhe kjo nuk dëshmohet me certifikatën e vdekjes së babait të tij dhe certifikatën e tij të lindjes. Vëllezërit dhe motrat ose paditësi mund të kenë hequr dorë nga trashëgimia e tij. Pozita e paditësit si trashëgimtar, nëse ajo kontestohet siç ka ndodhur në këtë rast, duhet të dëshmohet. Argumenti i paditësit se ai nuk ka mundur ta përfundojë procedurën e trashëgimisë për shkak se paditësi nuk kishte dokument pronësie nuk qëndron. Siç ia ka shpjeguar gjykatësi paditësit, i cili përfaqësohet nga avokati, vendimi i trashëgimisë vërteton vetëm trashëgiminë e përgjithshme dhe nuk merret me çfarë ka zotëruar personi i ndjerë.

b:

Meqë padia nuk mund të jepet për shkak se trashëgimia nuk është dëshmuar, gjykata në këtë rast nuk obligohet të marrë vendim në lidhje me atë nëse transferimi i pronësisë në vitin 1963 ishte i vlefshëm me ligjin jugosllav dhe nëse mbetet i vlefshëm me ligjin e zbatueshëm në Kosovë. Nëse të dyja rastet qëndrojnë, paditësit, me kusht që pozita e tij si trashëgimtar do të dëshmohet një ditë, do të mund t'i kthehet e drejta e pronësisë vetëm pasi legjislativi i Kosovës të ketë miratuar Ligjin për Kthimin i cili do të mbulonte çështjen e tij. Një ligj i tillë aktualisht nuk ekziston. Në këtë drejtim është në dorën e ligjvënësit të pasojë Propozimin Gjithëpërfshirës të Ahtisarit për zgjidhjen e Statusit të Kosovës, në bazë të nenit 143 të

Kushtetutës së Kosovës drejtpërsëdrejti i zbatueshëm dhe që madje e tejkalon vetë Kushtetutën, i cili në mënyrë eksplicite evidenton parakushtin që të adresohet kthimi i pronave.

Shpenzimet

Në pajtim me Nenin 12 të Ligjit të Dhomës së Posaçme dhe në përputhje me Rregullat procedurale plotësuese në lidhje me taksat gjyqësore në fuqi nga 13 dhjetori 2010, taksat e Dhomës caktohen në bazë të Nenit 10 Urdhëresës Administrative Nr. 2008/02 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës si vijon:

Për paditë me vlerë në shumën midis 5001-10000 Euro (Neni 10.1): 50 €

Për lëshimin e aktgjykimit (Neni 10.12): është e njëjtë me këtë që përmendet më lart.

Vlera e padisë përcaktohet nga gjykata në lidhje me shumën mbi 5001 Euro. Prandaj, shuma e taksave gjyqësore është 100 €.

Shpenzimet e procedurave gjyqësore barten nga pala humbëse, në këtë rast Paditësi.

Paditësi ka paguar tashmë shumën prej 50 €, në këtë mënyrë paditësi duhet t'ia paguajë Dhomës së Posaçme shumën shtesë prej 50 eurosh.

I padituri nuk ka paraqitur ndonjë kërkesë për ri-imbursim të shpenzimeve të veta të procedurave gjyqësore dhe meqë i padituri përfaqësohet nga avokati i vet, i padituri nuk ka të drejtë të marrë kompensim për tarifën e arsyeshme të avokatit.

Këshillë ligjore

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet Ankesë brenda 21 ditësh tek Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme. Ankesa duhet t'i dërgohet edhe palës tjetër dhe të dorëzohet tek Trupi Gjyqësor **nga Ankuesi** brenda 21 ditësh. Ankuesi duhet të dorëzojë tek Kolegji i Ankesave dëshminë se e ka dërguar Ankesën edhe tek pala tjetër.

Afati i paraparë fillon në mesnatën e asaj dite kur Ankuesit i është dërguar aktvendimi me shkrim.

Kolegji i Ankesave e refuzon ankesën si të papranueshme nëse Ankuesi nuk e parashtron atë brenda afatit të paraparë.

I Padituri mund të ushtrojë përgjigje tek Kolegji i Ankesave brenda 21 ditëve nga data kur i është dërguar ankesa, duke e dorëzuar përgjigjen edhe tek ankuesi dhe tek pala tjetër.

Ankuesi pastaj i ka 21 ditë afat pasi që t'i dërgohet përgjigja në ankesën e tij, për ta dorëzuar përgjigjen e vet tek Kolegji i Ankesave dhe për ta dërguar atë tek pala tjetër. Pala tjetër pastaj i ka 21 ditë afat pasi që t'i dërgohet përgjigja e ankuesit që të dorëzojë kundërpërgjigjen e tij tek Ankuesi dhe tek Kolegji i Ankesave.

Alfred Graf von Keyserlingk, Gjyqtar kryesues

Urdhër i brendshëm: ky aktvendim duhet tu dërgohet Palëve